

KUMTESA DHE SHËNIME

MENELLA TOTONI

TRAJTAT E PJESORES TË FOLJEVE ME TEMË MË LIKUIDE
NË TOSKËRISHTEN

Në shumicën e të folmeve të sotme gege pjesorja e foljeve me temë më likuide nuk merr formant dhe dallohet nga trajta e së tashmes veta e I vetëm nga gjatësia e zanores së theksuar¹. Në gegërishten e shkruar ajo merr formantin -ë. Përkundrazi në toskërishten e folur merr tri formante, me përdorim të ndryshëm në të folme të ndryshme, ndërsa në toskërishten e shkruar merr dy formante.

Në gegërishte, duke pasur parasysh prirjen e përgjithshme, formanti -ë u shtri për analogji edhe në pjesoren e foljeve të tjera me temë më bashkëtingëllore, ndërsa në toskërishte ka ndodhur e kundërta, formanti i foljeve më bashkëtingëllore të tjera po shtrihet për analogji në pjesoren e foljeve me temë më likuide. Ajo që ka më rëndësi, është fakti që ky proces ende s'ka përfunduar jo vetëm në toskërishten e folur, ku shpesh paraqitet mjaft i ndërlikuar, po edhe në toskërishten e shkruar.

Pjesoret e foljeve me temë më likuide në toskërishten e folur marrin këto formante: -ë, -ur, dhe -tur. Formanti -tur është vënë në dukje si i tillë edhe nga A. Xhuvani në studimin për pjesoret e shqipes². Ky formant nuk duket të jetë dhe shumë i ri, sepse gjendet edhe në materialet folklorike të arbëreshëve të Greqisë dhe te Grigor Gjirokastriti dhe është një shtrirje analogjike e formantit -ur dhe bashkëtingëllores fundore të temës të foljeve më -t (si: mbyt, këput etj.) e përhapur së pari në folje të tilla si: arrij, vete etj., që e bëjnë të kryerën e thjeshtë me -t-a. Po, nëqoftëse për këto foljet e fundit për këtë arsye nuk mund të flitet për formant -tur, për kategorinë e foljeve që po shqyrtojmë, kjo është e domosdoshme, meqë bashkëtingëlloret -t- del vetëm në pjesore. Sot në ndonjë të folme -tur mund të haset si formant i dytë edhe në folje me temë më zanore: për të lartur duart (Tërbaç-Vlorë).

Trajtat e pjesores së këtyre foljeve nëpër të folmet e toskërishtes formohen në këtë mënyrë:

1) Në toskërishten veriore:

a) Foljet që mbarojnë me temë më l, ll, rr, e r (< rr) dhe që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, marrin formantin -ë³, i cili si fun-

1) Me këtë pohim të përgjithshëm nuk duam të mohojmë faktin që në disa të folme hasen pjesore me -un të këtyre foljeve, ose që në tëtashmen v. I ato në disa të folme gege dalin me -i, po duam të vemë në dukje atë fakt që çfaqet si prirje e përgjithshme në gegërishten.

2) «Studime gjuhësore» Tiranë 1956, fq. 203.

3) J. Gjinari — *E folmja e Beratit*, «Bul. Shk. Shoq.» Nr. 1, 1957, f. 122. *Një vështrim mbi të folmen e Oparit*, «Bul. Shk. Shoq.» Nr. 3, 1957, f. 148-9; *E folmja e Skraparit*, «Bul. Shk. Shoq.» Nr. 1, 1958, f. 95; *Të folmet e Myzeqesë*, «Bul. U. Sht. të Tiranës, Seria Shk. Shoq.» Nr. 4, 1958 f. 92; *Mbi të folmen e Devollit*, «Bul. U. Sht. të Tiranës, Seria Shk. Shoq.» Nr. 4, 1960, f. 119; *Vërejtje mbi të folmen e Mallakastrës*, «Bul. U. Sht. të Tiranës, Seria Shk. Shoq.» Nr. 3, 1962, f. 162. S. Floqi — *Skica e së folmes së Dangëllisë*, «Bul. U. Sht. të Tiranës, Seria Shk. Shoq.» Nr. 8, 1958, f. 105; J. Thomaj — *E folmja e katundit Seman*, «Bul. U. Sht. të Tiranës, Seria Shk. Shoq.» Nr. 3, 1961, f. 189; M. Totoni — *Materialet të mbledhura në Përmet, Dëshnicë (Këlcyrë), Shqeri (Përmet), Leskovik.*

dor në disa të folme të këtij nëndialekti ka rënë: *dal(ë), mjel(ë), vjel(ë); mbjell(ë), ndjell(ë), mbështjell(ë), pjell(ë), sjell(ë), përcjell(ë), vjell(ë), çjerr(ë), nxjerr(ë), përmyjerr(ë), tjerr(ë)*; në disa të folme të rrethit të Përmetit, Skraparit etj.: *miel, viel; mbiell; piell; nxier, tier* etj.

b) Foljet e tjera që mbarojnë me temë më likuidet *l, ll, rr* e *r*, po që nuk e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, marrin formantin *-ur*: *çelur, falur, ndalur, ngelur, ngulur, (shkulur, shpërngulur), përkëdhelur, përkulur; prozvalur, shkelur, ulur (pëkulur), velur; kallur, kthjellur, mbyllur, pallur (shpallur), psallur, tallur; nderur, ngjirur, sëmurrur, therur, thurur, varur; harrur (tëharrur, tarrur), korrur, errur*. Po me këtë formant e bëjnë pjesoren edhe foljet me temë më likuide, që formohen nga një emër a mbiemër me anë parashtesash a në mënyra të tjera: *çmallur, përfillur, tëhollur (tollur), ngjallur; kumandarur* «komanduar», *përdorur; mburrur*.

Në të folmet e toskërishtes veriore përjashtimet nga këto dy rregulla, mund të themi, janë fort të rralla e të rastësishme. Kështu psh. në Seman, folja «tjer» e bën pjesoren *tjer(ë)* dhe *tjerur*.

II) Në të folmen e Leskovikut, që veçohet në këtë pikë nga të folmet e tjera të toskërishtes veriore, me formantin *-ë* e bëjnë pjesoren jo vetëm ato folje që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, po edhe disa që nuk e ndryshojnë: *folë, pshellë, korë, tarë*.

Folje të tjera që nuk e ndryshojnë temën në ligjërimin e brezit të vjetër hasen vetëm me formantin *-tur*: *ngultur, ngjalltur, palltur, thurtur, vartur*.

III) Në të folmet labe të Gjirokastrës, Kardhiqit, Lunxherisë, Libohovës, Muzinës, Mursisë, këtu mund të futim edhe të folmen çame të Konispolit, foljet që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, marrin rregullisht në pjesore mbaresën *-ë* si dhe në toskërishten veriore. Foljet e tjera më likuide, që nuk e ndryshojnë temën, marrin mbaresën *-ur* dhe në raste më të rralla në Konispol, Mursi, Labovë të Kryqit (Libohovë) *-tur*.

IV) Në të folmet e tjera të Labërisë (Kurvelesh, Bregdet, Mesaplik dhe Rrezomë) çështja e formimit të pjesores paraqitet më e ndërlikuar. Këtu janë ndërthurur prirje të ndryshme, bile të kundërta: nga një anë formanti *-ë* është shtrirë analogjikisht në të gjitha foljet me temë më bashkëtingëllore, nga ana tjetër formanti *-ur* është shtrirë, gjithashtu për analogji, në pjesoret me temë më likuide, kështu që sot ka folje që marrin në pjesore tri formante brenda një të folmeje psh.: *kall(ë), kalltur* dhe *kallur*.

Foljet që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, marrin formantin *-ë* dhe *-ur*: *dal(ë), pjell(ë), nxjerr(ë)* etj. dhe *dalur, mjelur, vjelur, mbjellur, pështjellur, pjellur, sjellur, vjellur, çjerrur, marrur, nxjerrur, tjerrur*. Për këtë kategori foljesh formanti më i përdorur është *-ë*, po në disa të folme, në mos mbizotëron i dyti, përdoren të dyja njësoj.

Foljet që nuk e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, marrin formantin *-ë, -tur* dhe *-ur*: *çkul(ë), fol(ë), shkel(ë), kall(ë), mbyll(ë), përdor(ë), ther(ë), harr(ë), korr(ë), etj.; kalltur, mbylltur, palltur, qulltur, kthilltur, ngjalltur, sëmurtur, thertur, thurtur, vartur, çjartur, përdortur; çkulur, folur, shkelur, kallur, mbyllur, ndërur, thirur, korrur, tarrur* etj. Nga këto formante *-tur* haset më dendur, po vetëm me foljet, tema e të cilave mbaron më likuidet *ll* e *r*⁴. Formanti *-ë* haset më shpesh me ato folje, tema

4) Në materialet folklorike të mbledhura nga G. Meyer-i tek arbëreshët e Greqisë dhe në përkthimin e ungjijve të Argjirokastritit, formanti *-tur* haset edhe me foljet, tema e të cilave mbaron me *l*: të *faltura* (arb. Gr.), *faltur, ngultur, shkeltur* (Argj.) (shembujt nga Argjirokastriti janë nxjerrë prej art. të cit. të A. Xhuvanit).

e të cilave mbaron me *l e rr*. Formanti *-ur* zëvendëson zakonisht formantin *-ë*, rrallë dhe vetëm në ligjërimin e njerëzve të shkolluar mund ta takosh në vend të formantit *-tur*. Kjo gjë të shtyn të mendosh për një përhapje të mëvonët të formantit *-ur* në këtë grup foljesh.

Në toskërishten e shkruar çështja e formimit të pjesores së këtyre foljeve qëndron kështu:

Në «Fjalorin e gjuhës shqipe» të Institutit të Shkencave (1954) të gjitha foljet që e ndërrojnë temën në të kryerën e thjeshtë, e formojnë pjesoren me formantin *-ë*: *çjerrë, nxjerrë, mjelë, ndjellë, pështjellë, sjellë, vjellë* etj.

Pjesoret e foljeve të tjera më likuide, ato që nuk e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, nuk jepen në këtë fjalor, sepse e formojnë pjesoren si gjithë foljet me temë më bashkëtingëllore, pra me *-ur*. Kjo bëhet e qartë, po të kihen parasysht mbiemrat dhe emrat asnjans që formohen prej tyre dhe që jepen si në glosa të veçanta, si gjatë spjegimit të fjalëve të tjera: i *çelur*, i *mbyllur*, i *ngjallur*, i *përlur*, të *këqyrurit*, të *mbikqyrurit*, të *përkëdhelurit*, të *ringjallurit* etj. Nuk e marrin këtë mbaresë mbiemri dhe emri asnjans që formohet nga pjesorja e foljes «korr»: të *lashtat e korra*, të *korrat*, të *korret*, *koha* e të *korrit*.

Një parim i tillë është zbatuar edhe në ortografinë e gjuhës shqipe të botuar në Bul. e Shk. Shoq. IV, 1956.

Në veprat e ndryshme letrare, në shtypin e përditshëm etj. pjesoret e foljeve më likuide formohen po në këtë mënyrë, por në mjaft raste vërehen edhe lëkundje.

a) «Ai kishte *dalë* nga Gjirokastra gjithsej një dy herë». (2⁵, f. 25), «Ka ftonj *mbjellë* vet e rritur vet në mes gjerdheve». (3, f. 74), «Apo u kanë *pjellë* bagëtia sivjet?» (5, f. 26), «... humbnë nga Mali i Thatë duke u *përcjellë* nga vështrimi i habitur i bariut». (6, f. 12), «... e kish *sjellë* në mëngjez». (6, f. 29), «... do ta kish *mbështjellë*» (6, f. 48). «Leku vat e ra në dëborë, mu te vëndi tek e pata *nxjerrë*». (3, f. 22), «Përgjigjen time s'e ke *marrë*» (1, f. 44).

b) — «Duke i *folur* me ndrojtje, ajo ja shkrepiti të qarit». (2, f. 27), «Po xha Trifoni *ngulur* në dritare shikonte të grynjat e s'bënte zë». (3, f. 59), «Të qofsha *falur* ty, o papu...» (3, f. 66), «Sa i mirë, thashë duke e *përkëdhelur*». (3, f. 23), «... e mbante zakonisht *përkulur*». (5, f. 93), «... në një cep kishte *çelur* një vrimë të vogël». (1, f. 202), «... s'i kish *shkelur* në *dyqan*». (1, f. 77), «Fëmijët qenë *ulur* kokë-kokë rreth sofrës...» (2, f. 16), «... kish *mbyllur* sytë pa puthur kurorën e së mbesës». (3, f. 39), «Buzët janë *mbyllur* për jetë». (1, f. 205), «E fati, për t'u *tallur* me fatkeqt, desh që ky t'ish Andrea». (3, f. 26), «Dhe e bëri pa *përfillur* se në shtrat të kësaj së neveriture kish lënë një lidhje gjaku». (3, f. 24), «... duke u *kallur* tmerin armiqve». (4, f. 51), «... ishin *qullur* prej lotëve». (1, f. 150), «... e kanë *shpallur* veten veteranë». (1, f. 83), «... do ta kishte *varur* në dollap». (2, f. 98), «Mendimet që kisha *thurur* për njerëzit shkuan e vanë». (3, f. 21), «Ka një javë që kanë *shterur*», (6, f. 51). «këtu e dhjet vjet më parë Xhel Bregut i qe *sëmurur* keq Luftëtari». (6, f. 19). «Ishte *errur*». (2, f. 69). «... u vërtit si shigjetë në mes të armiqve, duke *korrur* me shpatën më të djathtë e më të mëngjër...» (4, f. 40) etj.

Lëkundjet në toskërishten letrare çfaqen përgjithësisht në një drej-

5) Me numrat 1, 2 etj. shënohen veprat prej të cilave janë nxjerrë shembujt. Këto janë: 1. Nonda Bulka: *Kur qante e qeshte bilibili*, 2. Dalan Shaplllo: *Përtëritja*, 3. Jakov Xoxa: *Novela* (1949), 4. Fan Noli: *Historia e Skënderbeut* (1962), 5. Shefqet Musaraj: *Isha unë Çobo Rapushi*, 6. Fatmir Gjata: *Përmbysja*.

tim, në zëvendësimin e formantit -ë me formantin -ur në foljet që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë:

«Skënderbeu. u tregoi . . . shërbimet që i kishte *sjellur* botës Evropiane me fushatat e tij» (4, f. 112), «Unë e kam *sjellur* edhe një herë tjetër tek juve para një viti». (Dh. Khuvani: «Një natë pa dritë», Drita, 2 Prill 1964), «Nxënësit e shkollës së mesme Piero Mouho janë *përcjellur* pothuajse të gjithë në burgun politik». (Zëri i Rinisë, 27 Maj 1964, «Është fatkeq ai popull, rinia e të cilit i duron tiranët»). «Lek Dukagjini . . . duke *çjerrur* faqet . . . bërtiti më të djathtë e më të mëngjër lajmin e hidhur». (4, f. 115), « . . . tamam në kohën kur kishin *vjelur* misrin e suallën kokën njerzit e padëshëruar». (6, f. 79).

Raste kur folje që nuk e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, marrin formantin -ë, hasen fort rrallë me ndonjë autor mbartës i nëndialektit lab; p.sh. te Sh. Musaraj në «Isha unë Çobo Rapushi» gjejmë: *folë* (4 herë) krahas *folur* (3 herë), *korre* (1 herë): «Kurse mua më kanë *folë* mirë për të». (5, f. 56), «Rronte bashkë me gjyshen . . . verës duke *korre* me mëditje . . . » (5, f. 102).

Për ta bërë më të qartë përdorimin e këtyre formanteve po japim statistika nga vjelja tërësore në pesë vepra:

«Kur qante e qeshte bilbili» (N. Bulka) — Nga 25 pjesore foljesh me temë më likuide 15 janë pjesore foljesh që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë — që të tëra dalin me formantin -ë, 10 të tjerat janë pjesore foljesh që nuk e ndryshojnë temën në aorist — dalin vetëm me formantin -ur.

«Përtëritja» (D. Shaplo) — Nga 39 pjesore foljesh me temë më likuide 19 janë të grupit të parë dhe dalin me formantin -ë, 20 janë të grupit të dytë e dalin të gjitha me formantin -ur.

«Novela» (1949, J. Xoxa) — Nga 27 pjesore të tilla 14 janë të grupit të parë — të gjitha me -ë, 13 të grupit të dytë — të gjitha me -ur.

«Isha unë Çobo Rapushi» (Sh. Musaraj) — Nga 57 pjesore foljesh me temë më likuide 32 janë të grupit të parë — të gjitha me formantin -ë, 25 të tjerat janë të grupit të dytë, nga të cilat 20 dalin me formantin -ur dhe 5 me formantin -ë.

«Përmbysja» pjesa e I (F. Gjata) — Nga 77 pjesore të tilla 49 janë të grupit të parë, nga të cilat 48 me formantin -ë, 1 me formantin -ur, 28 të tjerat janë të grupit të dytë — të gjitha me formantin -ur.

Formanti -ur ka një përdorim më të gjerë në emrat dhe mbiemrat foljorë, që vinë nga pjesoret e foljeve që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë:

«Dy herë në mot më të korur e më të *vjelur* vinin ushtëritë Turke rregullisht përpara Krujës». (4, f. 117), «Ishte koha e të *vjelurit* të misërit». (6, f. 54), «Ai kujtoi se mos Gurka po ndiqte ndonjë dhi për ta *mjelur*». (6, f. 8). «Të gjata qenë stinët e mija, veç verës që zbriti sa për të *ndjellur* dimrin e zi». (3, f. 16), « . . . këto italianët i bënë për t'u *hakmarur*». (Zëri i popullit, 27 Maj 1964, «Njeriu që qëlloi kundër perandorit»). «Pastaj Skënderbeu i *përcjellur* prej nipërve dhe Pal Dukagjinit, u kthye në Krujë». (4, f. 33), «Në verë kalliri i *mbjellur* me farë të pabekuar plasi tokën . . . » (3, f. 68), « . . . harron borxhet e *marrura* » (1, f. 42).

Raporti i këtyre pjesoreve të substantivuara dhe të adjektivuara me -ë dhe -ur është:

«Kur qante e qeshte bilbili»: 3 me -ë, 1 me -ur.

«Përtëritja»: 6 me -ë, 0 me -ur.

«Novela»: 4 me -ë, 4 me -ur.

«Isha unë Çobo Rapushi»: 4 me -ë, 1 me -ur.

«Përmbysja»: 18 me -ë, 3 me -ur.

Pra, nga sa duket edhe nga kjo statistikë, ka një prirje drejt përdorimit me -ur të pjesoreve të substantivuara dhe të adjektivuara të foljeve që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë.

Në gramatikat shkollore të gjuhës shqipe pjesorja trajtohet tepër në përgjithësi. Në to nuk flitet veçan për problemin që shtron kjo kumtesë. Në «Pjesorja në shqipet»⁶, në «Morfologjia historike e shqipes»⁷ dhe në «Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe»⁸ mbaresa -ë e pjesores përgjithësohet për foljet me temë më likuide, megjithëqë A. Xhuvani dhe Sh. Demiraj, kur japin shembuj, përqëndrohen vetëm në folje që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë. Sa bëhet e qartë nga parashtrimi i mësipërm, një përgjithësim i tillë për toskërishten nuk duket i drejtë nga pikëpamja e shumicës së të folmeve dhe e toskërishtes së shkruar letrare.

Për trajtat e pjesores me -ë dijetarë të huaj dhe vendës kanë shprehur mendime të ndryshme.

G. Meyer-i⁹ shikon në formantin -ë një mbeturinë të formantit -në të pjesores, n e së cilës është asimiluar nga bashkëtingëllorja fundore e temës, kur kjo ka qenë një likuide, (r, l, l'): *nxierrë* < *nxiernë*, *vierrë* < *viernë*, *viel'ë* < *vielnë*, *viellë* < *viellnë* etj. Po kështu **lidhnë*, **viedhnë*, **dredhnë* duhej të bëheshin *lidhë*, *viedhë*, *dredhë*. Prej këtyre rasteve, vazhdon ai, -ë si formant i pjesores u përgjithësua në bazë të analogjisë edhe në foljet e tjera me temë më bashkëtingëllore si: *lypë*, *riepë*, *diegë*, *goditë*.

Pekmezi¹⁰ në format «e shkurtëra» të pjesores (të cilat dilnin me -ë, kur tema u mbaronte më konsonante) sheh një shkurtim të një infinitivi origjinar sot të humbur.

Këtë mendim të Pekmezit s'e pranon N. Jokli¹¹, i cili mbështet tezën se shqipes nuk i ka humbur ndonjë infinitiv, mendim që e ka parashtruar dhe argumentuar Pedersen (në I. F. anz. 12, 92 f.). Jokli gjithashtu nuk është i të njëjtit mendim edhe me Meyer-in. Sipas tij, duke u bazuar në ligjet fonetike, nga *lidhnë* e *vielnë* nuk duhet të kishim *lidhë* e *vielë*, po *linë* e *viel'ë*. Trajta *vierrë* që u qëndron ligjeve fonetike, nuk mund të bëhet pikënisje për të gjithë tipin, sepse bashkëtingëllorja fundore e temës të së tashmes dhe të pjesores nuk është e njëjtë: *vier* — *vierrë*, siç është e njëjtë te *dieg-diegë*. Mendimi i Joklit është që pjesoret me -urë dhe -ë vinë, në përputhje me ligjet fonetike, respektivisht nga kallëzorja dhe emërorja e mbiemrit foljor indoeuropian në -onos.

Në këtë mendim Jokli kundërshtohet nga M. La Piana¹² në këto dy pika: që trajtat e pjesores -ë dalin mjaft vonë (Buzuku, Budi, Bogdani, njohin vetëm format e plota) dhe që pas foljes ndihmëtare «kam» në formimin e kohëve të përbëra si: *kam hapë*, do të shkonte sipas logjikës kallëzorja dhe jo emërorja. M. La Piana e lidh zhdukjen e «sufiksave» — *unë* ose -m, në sand-hin sintaktik me faktor psikologjik. Mbasi folja ndihmë-

6) A. Xhuvani: *Vep. e cituar*.

7) M. Domi; *Konspkte leksionesh*, shtypur nga Dega e botimeve të Universitetit, Janar 1961, f. 65.

8) Sh. Demiraj; *Dispensë*, shtypur nga Dega e botimeve të Universitetit, Shkurt, 1961, pjesa e II, f. 242.

9) G. Meyer: *Albanesische Grammatik*, f. 42v.

10) Pekmezi: *Grammatik der albanesischen Sprache*, f. 194.

11) N. Jokli: *Beiträge zur albanesischen Grammatik* (3. Der Akkusativ-Nominativ und der Geschlechtswechsel im Albanesischen) I.F. XXXVI, f. 121 v.

12) M. La Piana: *Studi linguistici albanesi*, f. 89 v.

tare tregonte qartë funksionin e pjesores, «sufiksi» i mirëfilltë i këtij funksioni humbi.

Pekmezi dhe Jokli flasin për një fazë tepër të vjetër të gjuhës shqipe, duke përgjithësuar fakte relativisht të vonëta të gjuhës. Teza e Joklit nuk i qëndron dot rregullsisë thua se absolute të përdorimit të formantit *-ur* në pjesoren e foljeve me temë më bashkëtingëllore, përveç atyre me temë më likuide, dhe të përdorimit të formantit *-ë* vetëm në foljet më likuide në toskërishten veriore, në disa të folme labe dhe në çamërishte, në arbëreshët e Greqisë e të Italisë. Një rregullsi e tillë vërehet edhe te Buzuku¹³, ku foljet me temë më çdo bashkëtingëllore, veç atyre më likuide, dalin në pjesore me *-unë* (në dy raste me *-ënë* dhe në një me *-onë*): *hjekunë*, *ndjekunë*, *lëkondunë* etj., ndërsa foljet më likuide me *-ë*: *dalë*, *folë*, *mbërshelë*, *ncelë*, *nfalë*, *ngulë*, me *shkalë*, me *shkelë*, *shkulë*; *gjellë*, *mbjellë*, me u *ngjallë*, me *përcjellë*, *pështjellë*, *sjellë*; *bjerë*; *korë* (dhe *korë*), *marë*, *nxjerë* (dhe *nxjerrë*), *qyrë*, me *thirë*. Vetëm gjashtë folje që nuk e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, dalin me *-unë*, prej të cilave 5 vetëm me *-unë*: *delirunë*, *nderunë*, *ntherunë*, *qellunë*, dhe 1 kryesisht me *-unë*, po më të rrallë dhe me *-ë*: *ngjallunë* dhe *ngjallë*. Pikërisht ky fakt që mbaresa *-ë* e pjesores është e lidhur me temat më likuide, lind pyetjen: pse vetëm në këto folje u ruajt nominativi i mbiemrit foljor?

Mendimi i La Pianës, edhe nëqoftëse pranojmë që zanorja e gjatë në pjesoren *hāp* në gegërishte nuk vjen nga rënia e një *ë*-je, po nga rënia e formantit *-unë*, nuk sqaron si duhen spieguar trajta të tilla të pjesores si: *lodhë*, *hedhë* etj.¹⁴, që ndihen në Zagori dhe *folë*, *korë* etj., që ndihen në Leskovik. Ne nuk dyshojmë që trajtat e pjesores sot pa formant, me zanoren e rrënjës të gjatë ose të shkurtër (Labëri), kanë ardhur nga një pjesore me *-ë*. Pas kësaj mendimi i La Pianës që *-unë* ose *-m* ra, se folja ndihmëtare «kam» tregonte qartë funksionin participor në kohët e përbëra, nuk qëndron më, sepse atëhere, përsa u desh të lindte një *-ë* pasi ra *-unë*?. Nga sa del prej shembujsh të tillë si: *dhanun*, *dhënur*, *pamun* etj., në shqipe duket një tendencë e kundërt nga ajo që pohon La Piana: tendenca e dyzimit të mbaresës së pjesores dhe jo e eliminimit të saj.

Mendimi i Meyer-it mbetet më i pranueshmi, sepse ai vërtetohet nga materiali gjuhësor i folur dhe nga ai i shkruari që prej Buzukut e deri në ditët tona. Ne nuk jemi të një mendjeje me Meyer-in vetëm në një gjë: që edhe **lidhnë*, **viedhnë*, **dredhnë* duhet të kishin dhënë *lidhë*, *viedhë*, *dredhë*, meqë asimilimi i grupit *dhn* në *dh* është një fenomen analogjik, i përhapur këto dy tre shekujt e fundit, sidomos në toskërishten veriore, të cilin nuk e hasin te Buzuku; atje gjejmë rregullisht: *erdhnë* (58 b 22), *mbëlodhnë* (80 a 5) etj., ndërsa ka: *duolë* (76 e 33 < *duolnë*) *suollë* (78 b 29 < *suollnë*), *thirë* (78 b 12 < *thirnë*), *gjellë* (35 b 17, 20 < *gjellnë*), krahas *folnë* (16 b 39), *mbërshelnë* (178 b 18), *ncilnë* (43 b 14).

Të paktën që nga shekulli i XVI, siç na dëshmon Buzuku, po kjo mund të shkojë më thellë, ndoshta përtej shek. të XIV, po të kemi parasysh arbëreshët e Greqisë e të Italisë, formantet *-ur* dhe *-tur* (në të folmet që kemi përmendur) filluan të shtrihen edhe në foljet me temë më likuide. Nevoja për të dalluar trajtën e vetës së III shumës të së kryerës së thjeshtë nga ajo e pjesores (*falë*, *ngulë*, *velë*, *mbyllë* etj. — e kryera e thjeshtë veta e 3 shumës, *falë*, *ngulë*, *velë*, *mbyllë* — pjesore) ka qenë faktori vendimtar në këtë mes. Një nevojë e tillë nuk paraqitej për foljet që e ndry-

13) E. Lafe: *Trajtat e pjesores te Gjon Buzuku*, në «Konf. e I Alb.» f. 156 v.

14) M. Totoni: *E folmja e Zagorisë*, «Bul. U. Sh. T. Seria Shk. Shoq», Nr. 1, 1961, f. 202.

shojnë temën në të kryerën e thjeshtë (Buzuku: *suollë*, — e kryer e thjeshtë, *sjellë* — pjesore, ose Përmet etj.: puall — e kryer e thjeshtë, *piell* — pjesore), prandaj tek ato u ruajt më shumë formanti -ë. Zëvendësimi i formantit -ë të këtyre foljeve me -ur në të folmet labe ka ndodhur më vonë, nën ndikimin e këtyre dy faktorëve: kthimi i togut zanor *ie* në *je* pasi u çvendos theksi nga *i*-ja në *e*, dhe rënia e formantit -ë si tingull fundor. Në të folmet e toskërishtes veriore (Përmet, Skrapar, Korçë etj.) ku *ie* ruhet, ky zëvendësim nuk ndodh në asnjë rast, po përkundrazi në ato të folme ku *ie* > *je* (Seman-Myzeqe), megjithse rrallë, hasen pjesore të këtyre foljeve me -ur si: *tjerur*.

Është i drejtë gjithashtu mendimi i Meyer-it që prej këtyre foljeve mbaresa -ë është përhapur analogjikisht në të gjitha foljet me temë më bashkëtingëllore, e siç e ka vënë re dhe M. La Piana, kjo përhapje është tepër e vonët në shqipen. Argumenti kundër i Joklit se raporti *vier-vierrë*, s'është i njëjtë me *dieg-diegë* e prandaj nuk mund të bëhet pikënisje për të gjithë tipin, nuk u qëndron fakteve. Të paktën që nga Buzuku këto raporte dalin të njëjta jo vetëm për foljet me *r*, po edhe më likuide të tjera. Te Buzuku: *nxier* (7 b 11) — *nxjerrë* (145 a 43, sot *nxjerr* — *nxjerrë*), *dalmë* (181 a 29) — *dalë* (114 a 25), *siell* (44 a 30) — *sjellë* (103 b 23-4) etj. Në toskërishte ky fenomen është më i ri në kohë se në gegërishte dhe i kufizuar në disa krahina. Është më aktiv në krahinën e Bregut të Detit, po sa më në lindje të shkosh ai haset gjithnjë e më rrallë, aq sa në Kurveleshin e Sipërm formanti -ë në vend të -ur përdoret tepër rrallë. Duket që kemi të bëjmë me një fenomen që zë fill në këtë krahinë dhe që po përhapet në krahinat e tjera.

Po është interesant të theksohet se sa më e theksuar të jetë prirja drejt përgjithësimit të -ë-së, po aq e theksuar është dhe prirja e përdorimit të formantit -ur në vend të -ë-së në foljet më likuide që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë dhe, si mbaresë e dytë, në pjesoret e foljeve me -në (si *qënur* etj.), gjë që është karakteristike për periudha kalimtare, kur një mjet gramatikor zëvendëson një tjetër dhe që ka të bëjë me dobësimin e ndjenjës gjuhësore për atë rast.

Nga sa u tha më lart lidhur me pjesoren e foljeve me temë më likuide, mund të përfundojmë:

a) Në toskërishten e folur ka dy prirje: e para që përfshin shumicën e të folmeve toske, shkon drejt përgjithësimit të formantit -ur në të gjitha foljet me bashkëtingëllore, prirje që është vazhdim i një zhvillimi historik të hershëm, kurse e dyta, më e kufizuar dhe rezultat i një zhvillimi historik më të vonët, shkon drejt përgjithësimit të formantit -ë.

b) Në toskërishten e shkruar, më shumë se në toskërishten e folur vërehet prirja drejt përgjithësimit të formantit -ur.